



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2023:204409

Datë: 25.04.2024

Numri i dokumentit: 05619775

PKR.nr.338/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, kryetari i trupit gjykues-gjyqtari Alban Ajvazi, me bashkëpunëtorin profesional Leutrim Hoti, në çështjen penale kundër të akuzuarës R.B, për shkak të veprës penale Dhënia e ryshfetit nga neni 422 par.2 të KPRK-së, e akuzuar sipas aktakuzës së sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda PP/I.nr.209K/24 të datës 06.11.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 24.04.2024, në të cilën kanë marrë pjesë Prokurori i Shtetit, e akuzuara dhe mbrojtësi i saj, me datë 25.04.2024, mori, shpalli publikisht dhe përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

E akuzuara:

R.B, nga i ati Sh. dhe ëma S., e gjinisë L., e lindur më ..., në Londër, me vendbanim në Londer, ..., si dhe në Kosovë fshati ..., Komuna e Prishtinës, me nr. personal ..., ka të kryer shkollën e mesme, e gjendjes se dobët ekonomike, e divorcuar, nënë e dy fëmijëve, shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTORË

Sepse:

Me datë 20.08.2023 në kryqëzimin e rrugëve "Eduard Lir" dhe "Ahmet Krasniqi" në Prishtinë, zyrtarët policor me të ndaluar veturën me targa ... i kanë njoftuar drejtuesin e veturës që po i shqiptojnë gjobë për kundërvajtje, për prishje të rendit dhe qetësisë publike, më pas e pandehura R. ka dalë nga vetura duke ju drejtuar zyrtarëve policor T.B dhe E.P "hajde sa pare i doni se ju jeni mësua kështu me marr" ju ka ofruar zyrtarëve policor me të holla në duar duke i mbajtur me dy duart të hollat nga 50 (pesëdhjetë) euro diku 7-8 copa monedha të letrës, duke tentuar të ua jap të hollat në atë mënyrë që zyrtari policor të veproj në kundërshtim me detyrën zyrtare, me të parë polici T.B të hollat që ju kanë ofruar nga e pandehura menjëherë e ka njoftuar shefin e ndërrimi ti dërgon police të gjinisë femërore që të njëjtën ta shoqërojnë në stacionin policor për dekaltratë;-

Me këtë ka kryer veprën penale Dhënia e ryshfetit nga neni 422 par.2 të KPRK-së.

Andaj konform neneve 7, 17, 21, 38, 43, 46, 47, 48, 49, 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK-së, si dhe neneve 276, 364 dhe 449 KPPRK-së, të akuzuarën:

E GJYKON

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse e akuzuara brenda periudhës së verifikimit në kohëzgjatje prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen veprë tjetër penale dhe me **DËNIM ME GJOBË** në shumë prej **1,000 (njëmijë) Euro**, të cilin dënim me gjobë obligohet ta paguaj në afat prej një (1) viti, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në bazë të nenit 43 par.3 të KPRK-së, nëse të akuzuarit nuk dëshirojnë ose nuk mund të paguajë gjobën, gjykata mund të zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burgim. Kur dënimi me gjobë zëvendësohet me dënimin me burgim, njëzet (20) Euro gjobë llogaritet barabartë me një (1) ditë burgim.

Obligohet e akuzuara që të paguaj shpenzimet e procedurës dhe atë për paushallin gjyqësor shumë prej tridhjetë (30) €, në emër të Fondit për mbrojtjen e viktimave të paguajë shumë prej pesëdhjetë (50) €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë/Departamenti për Krime të Rënda, ka paraqitur aktakuzë nën shenjën PP/I.nr.209K/24 të datës 06.11.2023, ndaj të akuzuarës R.B për shkak të veprës penale Dhënia e ryshfetit nga neni 422 par.2 të KPRK-së.

Gjykata me datë 24.04.2024 ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar, gjatë së cilës seancë kanë prezantuar Prokurori i Shtetit, e akuzuara dhe mbrojtësi i saj, pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, gjykata të akuzuarës i'a dha mundësin për ta pranuar fajësinë apo të deklarohet e pafajshëm.

E akuzuara në shqyrtimin fillestar, deklaroi se e ka kuptuar aktakuzën në tërësi dhe me vullnet të plotë dhe të vetëdijshëm, për pasojat e pranimin të fajësisë, e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës së prokurorit të shtetit, si dhe është penduar, i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra penale, po ashtu ka kërkuar nga gjykata që t'i shqiptoj një dënim më të butë pasi që është e gjendjes së dobët ekonomike.

Prokurori i shtetit Shenaj Berisha lidhur me pranimin e fajësisë nga i akuzuari, ka deklaruar se: pajtohem me pranimin e fajësisë, ngase një pranim i tille është konform dispozitave ligjore dhe i mbështetur në provat që gjinden në shkresat e lëndës duke kërkuar nga gjykata që të aprovohet një pranim i tille, ndërsa sa i përket caktimit dhe llojit të dënimit që gjykata të merr parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese në mënyrë që dënimi të jetë në proporcion me peshën e veprës penale, sjelljen dhe rrethanat e kryerjes, shkallen e përgjegjësisë penale dhe motivin për kryerjen e veprës penale, sjelljen e mëparshme të kryerësit si dhe rrethanat personale si dhe sjelljen e saj pas kryerjes së veprës penale.

Mbrojtësja e të akuzuarës R.B, av. Zyhdi Axhemi lidhur me pranimin e fajësisë nga i mbrojturi i tij ka deklaruar se: e mbrojtura ime është duke kaluar një fazë shumë të rëndë dhe të dhimbshëm

meqë jeton ne Angli dhe është divorcar andaj kërkojmë nga gjykata me rastin e caktimit te dënimit te merr rrethana lehtësuese siç janë pranimi i fajësisë, premtimi se në te ardhmen nuk do te përsëris vepra penale është hera e pare qe e njëjta ka ren ndesh me ligjin, e njëjta është e gjendjes se dobët ekonomike.

Meqë e akuzuara e ka pranuar fajësinë në tërësi për kryerjen e veprës penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi paraprakisht është njoftuar nga gjykata, me benefitet dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i cili është bërë vullnetarisht, pranimi i cili mbështetet në faktet e çështjes dhe provat materiale që përmban aktakuza, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkëlqje ligjore apo gabim faktik, Gjykata vlerësoi se janë përmbushur të gjitha kërkesat ligjore nga neni 242 të KPPRK-së, që të pranohet deklarata e të akuzuarës për pranimin e fajësisë për kryerjen e kësaj vepre penale dhe të njëjtën edhe e ka aprovuar, pasi që pranimi i fajësisë gjen mbështetje edhe në provat tjera që gjenden në shkresat e lëndës, ashtu që nuk ka administruar asnjë provë për të vërtetuar gjendjen faktike.

Nga pranimi i fajësisë nga i akuzuari, në shqyrtimin fillestar u vërtetua se me datë, kohë dhe vend si në dispozitivin e aktakuzës së ngritur ndaj saj, ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Pranimi i fajësisë, po ashtu gjen mbështetje, në shkresat e lëndës siç janë: procesverbali i marrjes në pyetje i të pandehurës R.B me datë 02.10.2023, procesverbali i marrjes në pyetje i dëshmitarit T.B me datë 25.09.2023, procesverbali mbi marrjen në pyetje i dëshmitarit E.P i me datë 25.09.2023 dhe CD incizimi të siguruara nga objekti në rrugën ‘Ahmet Krasniqi’ në Prishtinë, nga të cilat rezulton se në veprimet e të akuzuarës formësohen të gjitha elementet qenësore objektive dhe subjektive të veprës penale Dhënia e ryshfetit nga neni 422 par.2 të KPRK-së.

Nga paragrafi par.2 i nenit 422 të KPRK-së, është parashikuar forma themelore e kryerjes së veprës penale Dhënia e ryshfetit nga neni 422 par.2 të KPRK-së, sipas së cilës dispozitë është paraparë se këtë vepër e kryen: “Kushdo që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, për vete apo për një person tjetër i premtton, ofron ose i jep ndonjë dhuratë të paarsyeshme apo përfitim tjetër personit zyrtar, në mënyrë që ai person të veprojë ose të mos veprojë në kundërshtim me detyrën e tij zyrtare, dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet”.

Ndërsa, nga pranimi i fajësisë nga e akuzuara, i cili pranim gjen mbështetje edhe në provat tjera që gjenden në shkresat e lëndës, del se në veprimet e të akuzuarës manifestohen të gjitha elementet e kësaj vepre penale.

Kështu që duke u bazuar në këto dispozita ligjore, gjykata e ka shpallur fajtor të akuzuarën, për shkak të veprës penale Dhënia e ryshfetit nga neni 422 par.2 të KPRK-së, ngase me veprimet e të njëjtës konsumohen të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njëjtat është edhe penalisht përgjegjës.

Gjykata me rastin e matjes dhe përcaktimit të lartësisë dhe llojit të sanksionit penal për të akuzuarin, i vlerësoi të gjitha rrethanat relevante rënduese dhe lehtësuese, në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, andaj si rrethanë veçanërisht lehtësuese për të akuzuarin mori faktin se, i njëjti e ka pranuar fajësinë, derisa si rrethanë lehtësuese gjithashtu vlerësoi, se është hera e parë që ka ra ndesh me ligjin, është e gjendjes së dobët ekonomike, pendimin e thellë dhe shprehjen e keqardhjes para gjykatës për kryerjen e kësaj vepre penale, ndërsa si rrethanë rënduese ndaj të akuzuarës gjykata gjeti mënyrën si e ka kryer veprën penale. Andaj gjykata duke i pasur parasysh

të gjitha rrethanat e lartcekura, i shqiptoj dënim e paraparë me ligj dhe sanksionin penal përkatës si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se ky sanksion i tillë penal, është në përputhshmëri të plotë me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të këtyre veprave penale dhe përgjegjësisë penale të të akuzuarës dhe se dënimet e shqiptuara do të ndikojnë në riedukimin, risocializimin dhe parandalimin e të akuzuarës dhe personave tjerë nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, me çka edhe do të arrihet qëllimi i përgjithshëm dhe i veçantë i dënimit komfor nenit 38 të KPRK-së.

Gjykata duke u bazuar në nenin 43 par.2 të KPRK-së, vendosi që afatin e pagesës sa i përketë dënimit, duhet të jetë 1 (një) vit për shkak të gjendje së dobët ekonomike të të dëmtuarës, dhe se njëjta është divorcuar dhe mbajtëse e familjes, andaj gjykata vlerëson se një afat i tillë është arsyeshëm siç përcaktohet në këtë dispozitë ligjore, ndërsa gjykata nuk caktoj që të paguhet me këse që e pandehura nuk jeton në Kosovë dhe sipas saj e njëjta vjen një herë në vite në Kosovë, në këto rrethana gjykata vlerëson se do të bëhet pagesa e shumës totale.

Vendimi lidhur me shpenzimet e procedurës penale kundër të akuzuarës , do të merret në bazë të llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate, ndërkaq shpenzimet në emër të paushallit gjyqësor janë marrë konform nenit 449 par.3 të KPRK-së.

Vendimi lidhur taksën për programin e kompensimit të viktimave u mor konform nenit 39 par 3, pika 3.2 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit (Ligji nr. 05/L036).

Nga arsyet e cekura më lartë, e në pajtim me dispozitat ligjore nga neni 364 të KPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINE
Departamenti për Krime të Rënda
PKR.nr.338/23, datë 25.04.2024

G j y q t a r i

Alban Ajvazi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.